

MUHAMMED NASURUDIN ALBANI

**NAMAZIN
E NATËS APO
NAMAZIN
E TARAVISË?**



Namazin e Natës apo Namazin e Taravisë?

Muhammed Nasiruddin
El-Albani

Shqipëroi: Besim Gjellaj



Përmbajtja

Parathënie.....	4
Vlera e namazit të natës gjatë netëve të ramazanit...	5
Nata e Kadrit dhe përcaktimi i kohës (datës) së saj.	7
Legjitimimi i faljes së namazit të natës me xhematë	8
Legjitimim i faljes së femrave me xhematë në namazin e natës	11
Numri i rekateve të namazit të natës.....	12
Leximi i Kur'anit gjatë namazit të natës	14
Koha e namazit të Natës.....	17
Formatë e namazit te natës.....	19
Forma e parë:	20
Forma e dytë:.....	20
Forma e tretë:	21
Forma e katërtë:	21
Forma e pestë:.....	21
Forma e gjashtë:.....	22
Të lexuarit në tre rekatet e vitrit	24
Duaja e kunutit dhe kur lexohet ajo në namaz	25
Çfarë duhet thënë në fund te vitrit	29
Dy rekate pas vitrit	30
ITIKAFI.....	31
Legjitimimi i tij	31

”E kur jeni të izoluar (në itikafë) në xhamia...” Bekare 187,	31
Kushtet e itikafit.....	33
”E kur jeni të izoluar (në itikafë) në xhamia, mos t’u afroheni atyre (për marëdhënie intime)” Bekare 187 ,	33
Çfarë lejohet për atë që është në itikaf.....	35
Lejohet ndaj gruas të bëjë itikaf dhe ta vizitojë bashkëshortin e vet në xhami:	37

Parathënie

E tërë lavdia dhe falënderimi qoftë për Allahun e Lartësuar. Paqja dhe mëshira qofshin mbi të Dërguarin e Tij, familjën, shokët dhe mbi ata që e pasojnë dhe e përkrahin sunnetin e tij.

Ky është botimi i dytë i librit tim “Namazi i natës në Ramazan” që e paraqes para lexuesit të ndëruar, i përshtatshëm për afrimin e muajit të begatshëm-Ramazanit, pasi që ekzemplarët e botimit të parë janë përfunduar, dhe kërkesat për të janë shtuar.

E shikova edhe njëherë duke e përmirsuar dhe korrigjuar, ia shtova shumë tah“rixhate* dhe dobi që nuk ishin më parë, kështu që të jenë te kënaqur (me këtë punë) lexuesit insheAllah. Prej më të rëndesishmëve që ka mundësi ta vërej lexuesi është në meselen e “Itikafit”.

E lus Allahun subhanehu ve te“ala të vërtetën ta bëjë shoqërues timin, dhe t“më falë mua çfarë më është shmangur nga e vërteta lapsi dhe kuptimi

im, dhe ta bëjë sinqerisht për Fytyrën e Allahut, me të vërtetë Ai është Falës, Fisnik.

Vlera e namazit të natës gjatë netëve të ramazanit

Për këtë kanë ardhur dy hadithe;

- 1) *Transmetohet nga Ebu Hurejre radij-Allahu anhu që ka thënë:*

”Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i inkurajonte muslimanët për t’u falur gjatë ramazanit duke mos i urdhëruar me urdhër të prerë”, pastaj thoshte:

”Kush falet në ramazan me besim të sinqertë dhe shpreson(tek All-llahu), do t’i falën mëkatët e kaluara”.

Kjo çështje vazhdoi deri në vdekje të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem , pastaj edhe në kohën e halifatit të Ebu Bekrit e deri në fillim të halifatit

të Umerit radijAllahu anhumam

2) *Hadithi i Amër ibën Murreh el-Xhubenij-j që ka thënë:*

”Erdhi një njeri nga fisi Kuda’ah tek Pejgamberi sal-LAllahu alejhi ve sel-lem dhe i tha:

”O i Dërguar i Allahut, çka mendon për mua nëse deshmoj se nuk ka të adburnar tjetër me meritë pos Allahut dhe se ti je i Dërguar i Tij, i fali pesë kohët e namazit, agjeroj dhe falem gjatë Ramazanit dhe e jap zekatin (si do ta kem përfundimin)? Pejgamberi sal-LAllahu alejhi ue sel-lem iu pergjig:”Kush vdes duke i bërë këto, do të jetë prej të sigurtëve dhe dëshmorëve”.

Nata e Kadrit dhe përcaktimi i kohës (datës) së saj

Nata më e vlefshme e muajit të ramazanit është Nata e Kadrit, bazuar në fjalën e

Pejgamberit sal-Allahü alejhi ue sel-lem:

“Kush falet në Natën e Kadrit dhe e qellon atë, me besim të singertë duke shpresuar (në shpërblimin e Allahut), do t'i falën mëkatet e kaluara“

Nata e Kadrit është nata e njëzetë e shtatë e ramazanit sipas mendimit më të saktë.

Për këtë aludojnë shumë hadithe, prej tyre është hadithi të cilin e

transmeton Zirr-rr ibën Hubejsi që ka thënë:

“E kam ndegjuar Ubej-j ibën Ka'abin duke thënë, pasi që i është thënë se Abdall-llah ibën Mes'udi ka thënë:”Kush falet gjatë terë vitit ia ka qelluar natës së kadrit! Tha Ubej-ji radij-j-Allahü anhu,(për Ibën Mes'udin,) Allahü e mëshiroftë, ka pas

për qellim që mos të bëhën njerzët përtacë, Betohem në Atë që nuk ka të adhuruar tjetër me të drejt pos Tij, Nata e Kadrit është në ramazan-betohet për Natën e Kadrit-dhe pasha Allahun e di në cilën natë është? Ajo është nata të cilën Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem na ka urdhëruar për t'u falë, ajo është nata e mëngjesit të ditës se njëzet e shtatë, dhe shënjë e saj është të lindë dielli në mëngjes të kësaj dite i ndriçuar pa rrezë”

Në një transmetim tjetër këtë e ka ngritur tek Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel- lem.

Legjitimimi i faljes së namazit të natës me xhematë

Është i legjitimuar të falurit e namazit te natës me xhematë në ramazan, përkundrazi është më i vlefshëm se sa të falurit vetmas. Kështu ka vepruar i Dëguari sal-lall- llahu alejhi ue sel-lem dhe ka sqaruar vlerën e tij,

ashtu siç përmendet në hadithin e Ebu Dherr-rrit radijAllahu anhu që ka thenë :”Kemi agjeruar ramażanin me Pejgamberin sal-LAllahu alejhi ue sel- lem dhe nuk është falur me ne asnjehërë gjatë muajit, derisa kanë mbetur shtatë ditë, pastaj është falur me ne derisa ka kaluar një e treta e natës dhe kur ishte nata e gjashtë nuk është falur me ne, në natën e pestë është falur me ne derisa ka kaluar një pjesë e natës; i thash:”O i Derguar i Allahut! Sikur të ishte falur me ne në këtë natë?! Më tha: Nëse njeriu falet me imam deri në fund do t’i llogaritet sikur të ishte falur gjatë gjithë natës. E kur ishte nata e katërt nuk është falur me ne, e në të tretën e ka bashkuar familjën dhe grat e tij, si dhe njerzët tjerë; dhe është falur me ne, sa që jemi frikësuar se po na kalon felahu,-thotë transemtuesi i hadithit-i thash; Çfarë është felahu? Më tha koha e syfyrit, pastaj nuk e ka falur me ne pjesën tjetër të mbetur të muajit”*

Shkaku që Pejgamberi sal-lAllahu alejhiue sel-lem nuk ka vazhduar ta falë namzin e natës me xhematë

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk ka vazhduar të falet me xhematë në pjesën e mbetur të muajit nga frika se mos bëhët obligim namazi i natës gjatë ramazanit e pastaj nuk do të kenë mundësi që t'i përmbahën këtij obligimi.

Ashtu siç përmëndet në hadithin e Aishes radiAllahu anha tek Buhariu, Muslimi dhe tek te tjerët. Me vdekjen e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel- lem, kjo frikë u largua, pasi që Allahu i lartësuar e plotësoi fenë e Tij. Për këtë shkak u largua frika, pra lënja e të falurit me xhematë e namazit të natës gjatë Ramazanit, ndërsa vendimi për faljen e këtij namazi me xhematë

ka mbetur i legjitimuar dhe mu për këtë Umeri radiAllahu anhu e ringjalli këtë vepër, ashtu siç tregohet në Sahihul Buhari dhe në libra të tjerë.

Legjitimim i faljes së femrave me xhematë në namazin e natës

U lejohet femrave të prezentojnë në namazin e natës me xhematë siç është treguar në hadithin e mësipërm të Ebu Dherr-rrit radijAllahu anhu. Gjithashtu lejohet për to të kenë imam të veçantë nga imami i mëshkujve.

Është vërtetuar se Umeri radijAllahu anhu kur i ka bashkuar njerzit për namaz të natës, për burra e ka caktuar imam Ubej-j ibën Ka‘abin radijAllahu anhu, ndërsa për femra Sulejman ibën Ebi Hathmeh.

Transmetohet nga Arfexheb eth-Thekafiu që ka thenë: “Ali ibën Ebi Talib radijAllahu anhu i urdhëronte njerzit për faljen e namazit të natës gjatë muajit të Ramazanit, caktonte një imam për mëshkuj dhe një për fëmra; Thotë Arfexheb: Unë isha imam i fëmrave”.

Unë mendoj se një gjë e tillë mund të veprohet nëse xhamia është e madhe, kështu që mos ta pëngojnë njëri-tjetrin.

Numri i rekateve të namazit të natës

Rekatet e këtij namazit janë **njëmbëdhjetë**, dhe mendojmë se nuk duhet shtuar më shumë në të, duke pasuar Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-em, sepse ai nuk ka shtuar më shumë derisa u nda nga kjo botë.

Është pyetur Aisheja radijAllahu anha për namazin e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem gjatë ramazanit? Është përgjigjur:

“Nuk ka falur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem më shumë se njëmbëdhjetë rekate gjatë ramazanit e as në kohët tjera, i falte katër rekate, mos pyet për bukurin dhe zëgjatjen e tyre, pastaj i falte edhe katër rekate dhe gjithashtu mos pyet për

bukurin dhe zgjatjen e tyre e pastaj falte tre rekate“

Lejohet për ta shkurtuar këtë namaz, edhe nëse e falë vetëm një rekat viter, duke u argumentuar me veprën dhe fjalët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Sa i perket argumentit nga vepra e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem,

është pytur Aisheja radij-Allahu anha: “Sa rekate e falte Pejgamberi sal-lall- llahu alejhi ue sel-lem vitrin? Tha: I falte kater rekate dhe tre rekate viter, gjashte rekate dhe tre rekate viter, dhjetë rekate dhe tre rekate viter, nuk ka fal me pak se shtatë e as më shumë se trembedhjetë rekate“

Kurse argumenti nga fjalët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është:

” Vitri është hak, kush dëshiron le ta falë pesë rekate, e kush dëshiron le ta falë tre rekate, e kush dëshiron le ta falë me një rekat ”

Leximi i Kur'anit gjatë namazit të natës

Sa i përket leximit të Kur'anit në namazin e natës gjatë ramazanit dhe muajve tjerë Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem nuk ka caktuar se sa të lexohet në të, kështu që mos të tejkalohet apo të mungohet, në realitet leximi i Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue sel-lem ndryshonte, ndonjeherë gjatë, e ndonjeherë shkurtë.

Ne disa raste ka lexuar në çdo rekat ngjashem me suren Muzemmil, njezetë ajete, e ndonjeherë afër pesdhjetë ajete,

dhe thonte: "Kush falet një natë duke lexuar njëqind ajete nuk do të shkrubet prej gafilime (pavëmendshëm)"

E në një hadith tjetër thotë:

"...me dyqind ajete shkrubet prej të bindurve në adhurim ndaj Allahut dhe prej të sinqertve".

Ka lexuar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem një natë duke qenë i sëmur, shtatë suret më të gjata, ato janë:

el-Bekare, Ali Imran, en-Nisae, el-Maideh, el-En`am, el-A`raf dhe et-Tevbeh.

Ndërsa në ngjarjën e Hudhejfete ibën el-Jemani që u fal pas Pejgamberit sal-lallahu alejhi ue sel-lem, tregohet se ai ka lexuar në një rekat el-Bekare, pastaj en- Nisae, pastaj Ali Imran, dhe ka kënduar duke e zbukurar zërin dhe ngadalë.

Është vërtetuar me transmetimin më të saktë që Umeri radij-jAllahu anhu kur e ka urdheruar Ubej-j ibën K`abin për t`ua falur namazin njerzve njëmbëdhjetë rekate gjatë ramazanit, Ubej-ji radij-jAllahu anhu lexonte nga njëqindë ajete derisa ata që faleshin pas tij u detyruan të mbeshtetën në shkopinjë si shkak i lodhjes duke qëndruar në këmbë, dhe nuk e përfundonin namazin deri në fillim te agimit.

Gjithashtu është vërtetuar nga Umeri radij-jAllahu anhu se njëherë kishte thirrur lëxuesit e Kur'an-it në muajin e ramazanit, dhe kishte urdhëruar më të shpejtin në lexim, prej tyre, që të lexojë tridhjetë ajete, të mesmin njëzetepesë ajete dhe më të ngadalshmin njëzet ajete.

Bazuar në këtë ai i cili falet vetëm le ta zgjatë sa të dëshirojë, dhe gjithashtu nëse është me të ndonjë që pajtohet për ta zgjatur le ta zgjasë, përrarsye se sa me shumë që e zgjatë namazin, ai namazi është më i mirë, mirëpo nuk duhet zgjatur duke qëndruar gjatë gjithë natës përveç në raste të rralla duke pas parasysh pasimin e

Pejgamberit sal-LAllahu alejhi ue sel-lem që thotë: "Udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhammedit sal-LAllahu alejhi ue sel-lem"

Nëse është imam, ai duhet ta zgjatë të falurit aq sa nuk e rendon xhematin, ngase

Pejgamberi sal-LAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Nëse ndonjëri prej jush iu behët imam njerzve, le të ua lehtësojë namazin, sepse në mesin e tyre është [fëmiu], i moshuari, i dobëti, [i sëmurë] dhe [ai që është i zënëun me nevoja], e nesë falet vetëm, le ta zgjatë sa të dëshirojë"

Koha e namazit të Natës

Koha e namzait të natës fillon pas namazit të jacisë e deri në agim, bazuar në fjalën e

Pejgamberit sal-LAllahu alejhi ve sel-lem: "Me të vërtetë Allahu ua ka shtuar një namaz, e ai është tek, pra faleni atë në mes jacisë dhe sabahut"

Falja e namazit në pjesën e fundit të natës është më i vlefshëm për atë që i mundësohet kjo gjë.

Pejgamberi sal-LAllahu alejhi ue sel-lem thotë: "Ai që ka frikë se nuk do të zgjohet në pjesën e fundit të natës, le ta falë vitrin në fillim të pjesës së parë të"

natës, e kush mendon se mund ta falë në pjesën e fundit le ta falë në atë kohë, se me të vërtetë namazi në pjesën e fundit të natës është i dëshmuar, dhe për këtë është më i vlefshëm”

Nesë çështja e të falurit ka të bëjë rreth të falurit në pjesën e parë të natës me xhematë apo në pjesën e fundit të natës vetëm, atëherë namazi me xhematë është më i vlefshëm, ngase konsiderohet ngjashëm me të falurit gjatë tërë natës, siç e kemi cekur më sipër, e cila tregohet nga sahabet se Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem e ka bërë një gjë të tillë.

Gjithashtu edhe sahabet në kohën e Umerit radij-Allahu anhu kanë vepruar kështu.

Abdurr-rrahman ibën Abdin el-Karij-ju thotë:”Kam shkuar një natë me Umerin në xhami gjatë ramazanit, e njerzit ishin të shpërndarë, ndokush falej vetëm, e me ndonjë tjetër falej një grup i vogël, atëherë Umeri tha: “Për Allahun! E

shoh të arsyeshme sikur t'i bashkoj këta në një imam, do të ishte më mirë, pastaj vendosi për një gjë të tillë, dhe i bashkoi më Ubej-j ibën K'abin. Pastaj shkuam një natë tjetër dhe njerzit ishin duke u falur me imamin e tyre, Umeri radij-Allahun anhu tha: "Sa risi e mirë është kjo, kurse ata që flejnë janë më të mirë se ata që falën ata falën në fund të natës kurse shumica e njerzve faleshin në fillim të natës"

Ka thënë Zejd ibën Vehb:

"Falej Abdullahi me ne gjatë muajit të ramazanit, dhe shkonte në shtëpi natën"

Formatë e namazit te natës

Një gjë të tillë e kam elaboruar qartë në librin "Salatut-Taravih" (Namazi i Taravis), f.101-105; dhe e shoh të arsyeshme ta cek shkurtimisht duke e bërë sa më të lehtë dhe përkujtuese për lexuesin:

Forma e parë:

Trembëdhjetë rekate, ia fillon me dy rekate të shkurtëra, të cilat sipas mendimit më të saktë janë dy rekatet sunet pas farzit të jacistë, ose janë dy rekate të posaqme më të cilat behët fillimi i namazit të natës siç e kemi potencuar më lartë, pastaj i falë dy rekate duke i zgjatur shumë, pastaj i falë dy rekate më të shkurtëra, pastaj i falë dy rekate më të shkurtëra se këto para tyre, pastaj i falë dy rekate më të shkurtëra se këto, gjithashtu i falë edhe dy rekate më të shkurtëra se këto, dhe në fund e falë vitrin një rekat.

Forma e dytë:

I falë trembëdhjetë rekate. Nga këto i falë tetë rekate duke jep selam mes çdo dy rekateve, pastaj e falë vitrin pesë rekate, duke mos u ulë e as duke mos dhënë selam

deri në rekatën e pestë.

Forma e tretë:

Njëmbëdhjetë rekate, jep selam pas çdo dy rekateve dhe e falë vitrin një rekat.

Forma e katertë:

Njëmbëdhjetë rekate, prej tyre katër i falë me një selam, gjithashtu edhe katër tjera, dhe i falë tre rekate viter.

A është ulur në mes dy rekateve kur e ka bërë të falurit me katër dhe tre rekate? Për këtë çështje nuk kemi gjetur përgjigje të mjaftueshme, mirëpo të ulurit në të falurit me tre rekate nuk është i legjitimuar!

Forma e pestë:

Njëmbëdhjetë rekate, duke i falë tetë rekate me një ulje, e lexon teshehudin dhe salavatën, pastaj ngritet nuk jep selam, dhe e

falë vitrin një rekat, pastaj jep selam kështu që bëhën nëntë rekate, pastaj i falë dy rekate duke qenë ulur.

Forma e gjashtë:

Nëntë rekate, duke i falë gjashtë rekate me një ulje, pastaj e lexon teshehudin si dhe salavatin mbi Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, pastaj... deri ne fund vazhdon ashtu siç është cekur në formën e sipërpërmendur.

Këto janë format e namazit të natës, te cilat janë vërtetuar nga Pejgamberi sal-lall- llahu alejhi ue sel-lem, të cekura në citate të transmetuara prej tij.

Mund të shtohën edhe forma të tjera përveç atyre që i cekëm, dhe kjo bëhët duke i manguar rekatet nga çdo formë aq sa deshirojmë, deri në një rekat, bazuar në fjalen e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të cekur me lartë:

”...kush dëshiron le ta falë vitrin pesë rekate, e kush dëshiron le ta falë tre rekate, e kush dëshiron le ta falë vitrin një rekat”

Këto forma të falurit në pesë dhe tre rekate, nesë dëshiron i falë me një ulje dhe një selam siç është cekur në formën e dytë, dhe nëse dëshiron jep selam mes çdo dy rekateve siç është cekur në formën e tretë dhe në format tjera, dhe kjo është më mirë .

Sa i përket të falurit pesë dhe tre rekate duke u ulur pas çdo dy rekateve dhe duke mos dhënë selam nuk kemi gjetur diq të vërtetë të transmetuar nga Pejgamberi sal- lAllahu alejhi ue sel-lem që aludon në të. Ne esencë është e lejuar, mirëpo pasi që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka ndaluar nga të falurit tek tre rekate, është marrë si argument fjala e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

”Mos i përgjasoni namazet me namaz të akshamit” , atëherë patjetër është obligim për atë që falë vitritin tre rekate që të largohet nga ky përgjasim, dhe kjo i ka dy rrugëdalje:

1. Te dhëniturit selam mes dy rekateve dhe rekatit të fundit, ky është mendim i fuqishëm dhe më i mirë.
2. Të mos ulet mes dy rekateve dhe rekatit të tretë. Allahu i lartësuar e di më së miri.

Të lexuarit në tre rekatet e vitrit

Në rekatit e parë të namazit të vitrit është sunnet të lexohet: “Seb-bih-ismi rab- bikel-,ala“, ndërsa në të dytin: “Kul ja ej-juhel-kafirun“ dhe në të tretin: “Kul huvall-

llahu ehad“. Nganjëherë pas “Kul huvAllahu ehad“ shtonte “Kul eudhu birab-bil- felek” dhe “Kul eudhu birab-bin-nas”.

Gjithashtu është vërtetuar nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se një herë në një rekat të vitrit ka lexuar njëqind ajete nga sureja En-Nisa .

Duaja e kunutit dhe kur lexohet ajo në namaz

Pas mbarimit nga leximi dhe para rukus, nganjëherë e lexon duan e kunutit të cilën ia kishte mësuar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nipit të vet Hasen ibn Alij radij-jAllahu anhuma, dhe ajo është:

“Allahume ihdini fimen hedejt, ve afini fimen afejt, ve tevl-leni fimen tevejte, ve berik li fime „atajt, ve kini sherr-rre me kadajte, fe in-neke takdi ve la jukda alejke, ve in-nehu la jedhil-lu men velejte, ve la jeiz-zu men adejte, teberekte rab-bena ve tealejte, la menxhe minke il-la ilejke“

(O Allahu im, më bëj mua prej atyre që Ti i ke udhëzuar, dhe më bëj prej atyre që Ti i ke falur, më bëj prej të dashurve Tu, më beko mua në atë që më ke dhënë dhe më mbroj nga dëmi i asaj që Ti ke caktuar. Vërtet, Ti je Ai i Cili cakton dhe askush s'kund të caktojë kundër Teje asgjë. Me të vërtetë s'ka mposhtje për atë të cilin Ti e do, dhe s'ka ndihmë për atë që është armik i Yti. I madhëruar dhe i Lartësuar je, O Zoti ynë. S'ka shpëtim prej Teje, përveç se të Ti).

Nganjëherë dërgon salavat mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ue sel-lem pas leximit të duas.

Nuk ka të keqe nëse e lexon duan e kunutit pas rukus, duke shtuar në dua mallkimin ndaj pabesimtarve, salavatit mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ue sel-lem dhe dua për muslimanët në pjesën e dytë të muajit të ramazanit gjë e cila është vërtetuar në transmetime nga imamët në

kohën e Umerit radij-jAllahu anhu.

Transmetohet në fund të hadithit të Abdurr-rrahman ibën Abdi el-Karij-j të cekur më sipër. I mallkonin pabesimtarët në pjesën e dytë të ramazanit;“

Allahume katilil-keferetl-ledhine jesud-dune an sebilike, ve jukedh-dhibune resuleke, ve la ju“munune biva“dike, ve halif bejne kelimetihim, ve elki fi kulubihim err-rr“ube, ve elki alejhim rixhzeke ve adhabeke, ilahel-hak-ki“

(O Allahu im, vëra ata pabesimtarë që i pengojnë të tjerët nga rruga Jote, që i përgnjështrojnë të Dërguarit Tu, dhe nuk besojnë në premtimin Tënd, bëri të përqarë mes veti, futju në zëmrat e tyre trishtimin, dërgoju atyre denimin Tënd, O i Adhuruari (Zoti) i vërtetë), pastaj dërgohet salavat mbi Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe bëhet dua për muslimanët aq sa ka

mundesi për të mirë, pastaj krkoni falje për besimtarët.

Ka thënë:

Pasi i mallkonte pabesimtarët, salavatet mbi Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, falje për besimtarët dhe besimtarët si dhe për vetëvetën thoshte:

“Allahume ij-jake n“abudu, ve leke nusal-li ve nesxhudu, ve ilejke nes“aa ve nahfidu, ve nerxhu rahmeteke rab-bena, ve nehafu adhabekel-xhed-de, in-ne adhabeke limen adejte mulhakun“

(O Allahu im, vetëm Ty të adhurojmë, për Ty falemi dhe vetëm Ty të përulemi, kah Ti vijmë dhe shpëjtojmë, shpresojmë në mëshirën Tënde, o Zoti ynë, frikësohemi nga denimi Yt i madh, Vërtetë denimi Yt do t“i godasë ata që kundërshtuan), pastaj e thoshte tekbirin dhe shkante në sexhde.

Çfarë duhet thënë në fund te vitrit

Prej sunnetit është të thuhet në fund te vitrit (para apo pas selamit):

”Allahume in-nii eudhu bike biridake min sehatike, ve bimuafetike min ukubetike, ve eudhu bike minke, la uhsi thene“en alejke, ente keme ethnejte ala nefsik” ,

(O Allahu im, të lutëm me anë të kënaqësisë Sate të më mbrosh nga hidhërimi Yt dhe me faljen Tënde nga denimi Yt. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga Ti. Unë nuk mund të të madhëroj ashtu siç e meriton Ti. Ti je i Madhëruar, ashtu siç e ke përshkruar Vetën).

Kur të jep selam në namaz te vitrit, thotë:

“Subhane el-melikul-kud-dus, subhane el-melikul-kud-dus, subhane el-melikul-kud-dus, d.m.th. tre herë, dhe e zgjatë zërin dhe

e ngrit në të tretën herë , (I Madhëruar qoftë Sunduesi i Pastër nga çdo e metë).

Dy rekate pas vitrit

Lejohet me i falë dy rekate, të cilat janë vërtetuar nga praktika e Pejgamberit sal- lAllahu alejhi ue sel-lem, perkundrazi ka porositur umetin e tij që t'i falin këto dy rekate duke thënë:

”Më të vërtetë udhëtimi ka mundime dhe lodhje, në qoftë se dikush e falë vitrin, le t'i falë dy rekate, e nesë zgjohet me vonë atëherë ato dy rekate i majftojnë (nuk ka nevojë për t'i falur prap)”

Në këto dy rekate është sunnet të lexohet surja “El-zilzal” dhe “El-kefirun”.

ITIKAFI

Legjitimimi i tij

Itikafî është sunnet gjatë ramazanit dhe gjatë tërë vitit. Argument për këtë kemi fjalën e Allahut të lartësuar:

**”E kur jeni të izoluar (në itikafë) në xhamia...”
Bekare 187,**

duke pas parasysh edhe shumë hadithe të vërteta të transmetuara për itikafin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem si dhe transmetime të shumta nga selefî që aludojnë për një veprim të tillë, të cilat janë të përmendura në librin Mus-sanef të Ibën Ebi Shejbeh dhe të Abdurr-rrezakut.

Është vërtetuar që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka bërë itikaf dhjetë ditët e fundit të muajit Sheval dhe Umeri radij-jAllahu anhu i kishte thënë :

”Ne kohën e xhabilijetit jam zotuar se një natë do të bëjë itikaf në qabe? I tha:”Atëherë përmbushe zotimin tënd” dhe ai bëri itikaf një natë.

Itikafi i transmetuar në mënyrën më autentike është itikafi në ramazan, këtë e vërteton hadithi i Ebu Hurejres radij-jAllahu anhu:

”Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bënte itikaf në çdo ramazan dhjetë ditë, kurse në vitin të cilin ka vdekur ka bërë itikafë njëzet ditë”

Itikafi më i vlefshëm është ai që bëhet në fund të ramazanit, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem hynte në itikaf gjatë dhjetë ditëve të fundit të ramazanit, derisa i erdhi vdekja prej Allahut az-zevexhel-l.

Kushtet e itikafit

Nuk lejohet dikund tjetër përveç në xhamia.

Allahu i lartësuar thotë:

”E kur jeni të izoluar (në itikafë) në xhamia, mos t’u afroheni atyre (për marrëdhënie intime)” Bekare 187 ,

ka thënë Aisheja radij-jAllahu anha:

”Është sunnet për atë që benë itikaf të mos dalë nga xhamia përveç për nevoja të tij të domosdoshme, nuk i lejohet të vizitojë të sëmurin, ta prek gruan e as nuk i lejohet të kryej marrëdhënie intime me të, gjithashtu itikafi bëhet vetëm në xhamit në të cilat falën pesë kohët me xhematë si dhe ai që bën itikafë duhet të jetë agjerueshëm”.

Duhet të jetë në xhami të cilën falet xhumaja, kështu që mos të ketë nevoj për të dalur nga

xhamia për ta falur xhumanë, sepse dalja nga xhamija për ta falur xhumanë është vaxhib,

thotë Aisheja radij-jAllahu anha në një transmetim të hadithit të saj të cituar në hadithin e mësiperem:

”...nuk ka itikaf përveç në xhami në të cilën falet xhumaja”

Më pastaj kam hasur në një hadith të vërtetë, të qartë, që i veçon xhamiat (për itikaf) të përmëndur në ajet me tri xhamitë:

Qabeja, xhamija e Pejgamberit sal-LAllahu alejhi ue selem dhe xhamin e Aksas, e ai është hadithi i Pejgamberit sal-LAllahu alejhi ue sel-lem:”Nuk ka itikaf përveç në tri xhamia”

Një gjë të tillë e kanë pohuar edhe selefë: Hudhejfetul-Jeman, Seid ibën el-Musej-jeb dhe Atau, përveç se ky i fundit nuk e ka përmëndur xhamin e Aksas, kurse disa të tjerë kanë thënë se lejohet itikafi në çdo xhami që falet xhumaja, e disa të tjerë e kundërshtuan këtë mendim duke

thënë:

itikafi mundë të bëhët edhe nëse është xhamia në shtëpi të atij që bënë itikaf.

Nuk është e panjohur se të përmbajturit asaj që është në pajtim me hadithin është i duhur, dhe duhet pasuar atë. Allahu i lartësuar e di më së miri.

Është sunnet agjerimi ndaj atij që bënë itikaf, siq është cekur më lartë ne hadithin e Aishes radij-jAllahu anha.

Çfarë lejohet për atë që është në itikaf

Lejohet të dalë nga xhamija për kryerje të nevojave fiziologjike, si dhe lejohet ta nxjerrë kokën jashtë për ta pastruar.

Aisheja radij-jAllahu anha thotë: "I Dërguari i Allahut e fuste kokën brënda në dhomën time

duke qenë në itikaf në xhami, unë isha në dhomë duke ia mbathur mestet, në një transmetim tjetër thubet e pastroja, mes meje dhe tij ishte vetëm pragu i derës dhe unë isha me menstruacione, nuk hynte në shtëpi përveç për nevojë të njeriut kur është në itikaf.

Lejohet për atë që është në itikaf dhe për të tjerët me marrë abdes në xhami, bazuar në fjalën e një njeriut që i kishte shërbyer Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

”Mori abdes Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në xhami, abdes te lehtë”.

Lejohet të marrë tendë të vogël, ta vendosë në fund të xhamisë dhe të bejë itikaf në të, sepse Aisheja radij-jAllahu anha ia sillte të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem hibaen (tendë) kur ishte në itikaf, ngase i Dërguari kështu e kishte urdhëruar”.

Nganjëherë bënte itikaf në ndonjë tendë që kishte një strehë si qadër në skaje të cilës kishte haser.

Lejohet ndaj gruas të bëjë itikaf dhe ta vizitojë bashkëshortin e vet në xhami:

Lejohet që gruaja ta vizitojë bashkëshortin e saj duke qenë ai në itikaf, si dhe për burrin ta përcjell gruan e vet deri të dera e xhamisë,

sipas fjalës së Safij-jes radij-jallahu anha: "Ishte i Dërguari sal-LAllahu alejhi ue sel-lem në itikaf, dhjetë ditët e fundit të ramaẓanit, unë e vizitoja natën, në prani tek ai ishin edhe gratë tjera të tij, pastaj ato shkonin, bisedoja me të diku një orë, pastaj dëshirova të shkoj dhe më tha:

"Prit do të vij më ty, erdhi më mua për të më përcjellur, dhe vëndbanimi i saj ishte tek shtëpia e Usame ibën Zejd, derisa arritën tek dera e xhamisë e cila është afër derës së Ummu Selemeh, aty pari kaluan dy burra nga Ensarët, posa i pa i

*Dërguari i Allahut sal-LAllahu alejhi ue sel-lem
nxçitoi dhe iu tha:*

*“Kujdes ajo është Safij-jeh bint Hujej-j!” Ata ia
kthyen:” Subhanall-llah!” O i Dërguar i Allahut!*

*Atëherë Pejgamberi sal-LAllahu alejhi ve sel-lem
tha: “Më të vërtetë shejtani leviz në trupin e njeriut
sikur gjaku, dhe unë u frikesova që të mbetët në
zëmrat tuaja e keqja, ose ka thënë të mbetët diç”*

Po ashtu është e lejuar të bëjë itikaf me burrin e vet
ose vetëm,

*thotë Aisheja radij-jallahu anha:”Ka hyrë në
itikaf me të Dërguarin e Allahut një grua nga
gratë e tij duke qënë me istihadë (në një transmetim
thuhet se ajo ishte Ummu Selemeh), nganjëherë i
shfaqej leng me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë,
vëndoste pamuk në organ dhe kështu falej”.*

Gjithashtu në një transmetim tjetër thotë:

*”Ka hyrë i Dërguari i Allahut në itikaf dhjetë
ditët e fundit të ramazanit derisa i erdhi vdekja*

*nga Allahu, pastoj vazhduan me itikaf pas vdekjes
gratë e tij sal-LAllahu alejhi ue sel-lem”.*

Them (Albani): Nga ky hadith argumentohet të lejuarit e itikafit për femrat dhe nuk ka dyshim se kjo është e kufizuar me lejen e të afërmëve të tyre, duke pas parasysh mos shfaqjes së fitnes dhe mos përzirja e tyre me mëshkuj, bazuar në shumë fakte që kanë të bëjnë me këtë çështje, në një rregull të fik“hut thuhet:”Largimi nga e keqja i paraparin asaj që sjell të mira”

Prej gjërave që e prishin itikafin janë marrdhëniet intime. Allahu thotë:

“E mos bëni mardhënje me to e ju duke qenë në itikaf në xhamija” Bekare 187.

Ka thënë Ibën Ab-basi radij-jAllahu anhuma:

”Në qoftë se kryen marrdhënie intime ai që është në itikaf, itikafi zhvlerësohet dhe rifillohet”.

Nuk ka shpagim për këtë si shkak i mos transmetimit nga Pajgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe as nga sahabët e tij.

“I Lartësuar qofsh, o Allahu im, Ty të takon lavdia, dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Teje, kërkoj faljen Tënde dhe te Ti pendohem”.

Perfundoi kontrollimi, korrigjimi si dhe bashkangjitja e dobive të reja, me lapsin e autorit në agimin të ditës së diel, 26, Rexheb, të vitit 1406h, ue sal-lAllahu ala Muhammedin-nebij-jil-umij-j, ue ala elihi ue sahibihi ue sel-lem.

Amman - Jordani

Nga dietari: Muhammed Nasirud-din Albani

Shqipëroi: Besim Gjellaj

